

### SHQIPËRIA

- Shqipëria pësoi dy goditje të njëpasnjëshme me pasoja shkatërruese: tërmeti i Nëntorit 2019 dhe pandemia COVID-19 në pranverën e vitit 2020 e cila ka ngrirë një pjesë të madhe të ekonomisë.
- Varësia nga turizmi, lidhjet e ngushta me ekonominë italiane të prekur ndjeshëm nga pandemia dhe hapësira e kufizuar fiskale e bëjnë Shqipërinë veçanërisht të ndjeshme ndaj krizës së COVID-19.
- Edhe sipas skenarit bazë, në të cilin supozohet se shumica e aktiviteteve ekonomike mund të rinisin në fillim të verës, rritja vjetore e PBB-së pritet të tkurret me 5 përqind në vitin 2020.
- Recesioni dhe masat mbështetëse ekonomike parashikohet të zgjerojnë deficitin fiskal në 5.4 të PBB-së në vitin 2020, duke e rritur borxhin e qeverisë deri në 75.8 përqind të PBB-së.
- Pasi të tejkalohet kriza, normalizimi i aktivitetit ekonomik dhe procesi i rindërtimit për zbutjen e pasojave të tërmetit pritet të mbështesin një rritje të shpejtë, por në planin afatmesëm nevojiten reformat strukturore.
- Për shkak se kriza COVID-19 është e paprecedentë, parashikimi shoqërohet me një nivel të pazakonshëm dhe të lartë pasigurie.

#### Zhvillimet e Fundit Ekonomike

**Shqipëria pësoi dy goditje të njëpasnjëshme me pasoja shkatërruese: një tërmet i fuqishëm në fund të 2019-s dhe pandemia globale e COVID-19 në fillim të 2020-s.** Efektet e këtyre goditjeve dominojnë zhvillimet e fundit ekonomike dhe perspektivën afat-shkurtër të ekonomisë.

**Tërmeti që goditi Shqipërinë në 26 Nëntor kishte pasoja të rënda.** Tërmeti, me magnitudë 6.3 sipas shkallës Rihter, shkaktoi 51 viktima dhe shpërnguljen e 17,000 njerëzve që humbën shtëpitë e tyre. Dëmet në kapitalin fizik dhe humbjet vlerësohet të jenë sa ekuivalenti i rreth 7.5 përqind të PBB-së. Dëmet arritën në 26.4 përqind të formimit të kapitalit fiks bruto të vitit 2018. Dëmet më të rënda ishin në turizëm dhe godinat e banimit<sup>1</sup>, por dëmtime pësuan dhe ndërtesat që lidhen me arsimin, shëndetësinë dhe infrastrukturën tjetër publike, prodhimin dhe tregtinë. Veprimet e ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe partneret ndërkombëtarë ndihmuan në zbutjen e ndikimit negativ njerëzor dhe ekonomik.

**Ritmet e rritjes ekonomike u ngadalësuan nga 4.1 përqind në 2018 në një nivel të vlerësuar prej 2.2**

**përqind në 2019.** Thatësira kishte zvogëluar prodhimin e energjisë që në gjysmën e parë të vitit 2019. Për shkak se projektet e mëdha të energjisë të financuara nga IHD-të ishin në fazën e përfundimit, investimet u ngadalësuan dhe konsumi u bë faktori kryesor shtytës i ekonomisë. Kur tërmeti i Nëntorit destabilizoi PBB-në e T4, si konsumi ashtu edhe investimi u tkurrën në mënyrë dramatike.

**Ndërsa në Shkurt 2020 në konferencën e donatorëve u arrit të mblidheshin 1.15 miliardë euro për rindërtimin nga tërmeti, në Mars pandemia COVID-19 e zhyti vendin në një krizë të paprecedentë të shëndetit publik, e cila ende nuk ka përfunduar.** Për të frenuar përhapjen e virusit, Shqipëria urdhëroi bllokimin e përkohshëm të aktiviteteve të rëndësishëm ekonomikë si restorantet, dhe tregtinë e artikujve jo jetik; kufizoi lëvizjen e njerëzve; dhe aplikoi kufizime të gjera në udhëtimet brenda vendit dhe ndërkombëtare. Shumë industri të lejuara për të vijuar aktivitetin si ato të tekstileve, minierave, qendrave telefonike (call centers), dhe ndërtimit, u është dashur të tkurrin aktivitetin e biznesit për të respektuar kufizimet. Duke pasur parasysh ndërprerjet aktuale të aktiviteteve dhe paqartësinë në lidhje me atë që do të ndodhë, si

<sup>1</sup> 11,490 njësitë e banimit të kategorizuara si të shkatëruara plotësisht ose të shembura duhet të rindërtohen. Gjithashtu dhe 83,745 njësi banimi kishin dëmtime më të lehta, dhe kanë nevojë për riparime dhe meremetime. Në bashkinë e Durrësit, destinacioni më i madh turistik i

Shqipërisë, nuk u shkatërruan shumë hotele, por shumë ndërtesa banimi jepen me qira për turistët.

## RRrE për Ballkanin Perëndimor #17

familjet ashtu edhe bizneset po shtynë kryerjen e shpenzimeve jo-jetike. Gjithashtu destabilizimi i rëndë ekonomik në partnerët kryesorë tregtarë, siç është Italia, kanë çuar në kolaps porosinë për produktet e eksportit.

**Shqipëria hyri në periudhën e krizës me pak hapësirë për të vepruar nëpërmjet politikës fiskale dhe monetare.** Megjithë një rënie graduale të borxhit publik dhe konfirmimit të vlerësimit të S&P në B + në Shkurt, borxhi publik, i cili në fund të 2019-s arriti në 68 përqind të PBB-së, është ende i lartë. Gjithashtu të larta janë dhe detyrimet potenciale dhe rreziqet fiskale nga partneritetet publike-private dhe ndërmarrjet shtetërore të energjisë. Për më tepër, me uljen e normës bazë të interesit në 0.5 përqind në mars 2020 në përgjigje të pandemisë, hapësirat për një politikë më konvencionale monetare janë shumë të kufizuara.

**Bankat janë të mirëkapitalizuara, me likuidet të lartë dhe kryesisht financohen nga depozitat.** Kreditë me probleme (NPL) janë zvogëluar përmes nxjerrjes së detyruar jashtë bilancit, shitjeve dhe zgjidhjes jashtëgjyqësore të tyre. Pas ndërhyrjes së bankës qendrore për të adresuar mbizotërimin e euros në transaksionet e brendshme, pjesa e kredive në valutë në totalin e kredive ra nga 60 përqind në 2015 në 50.1 përqind në vitin 2019. Depozitat në valutë, të cilat në një farë mase reflektojnë nivelin relativisht të lartë të remitançave, u rritën në 54.6 përqind të totalit të depozitave.

**Deficiti i llogarisë rrjedhëse (CAD) ishte i madh që para fillimit të krizës, por ishte i mbrojtur nga rezervat.** CAD u zgjerua nga 6.7 përqind e PBB-së në 2018 në 7.6 përqind në 2019. Pavarësisht nivelit rekord të të ardhurave të larta nga turizmi në 2019, eksportet e ulëta të mallrave dhe energjisë si dhe importet e larta të energjisë çuan në zgjerimin e CAD. Investimet e huaja direkte (IHD) në Shqipëri ranë në 7.6 përqind të PBB-së për shkak të përfundimit të fazës së investimeve të projekteve të mëdha të transmetimit të energjisë dhe gazit. Rezervat e këmbimit valutor, të cilat janë rritur në mënyrë të qëndrueshme për disa vjet, arritën në 3.3 miliardë euro në fund të 2019-s; niveli i tyre mbulon

ekuivalentin e më shumë se 6 muaj të importeve të mallrave dhe shërbimeve dhe kjo përbën një mbrojtje adekuate kundër goditjeve të pafavorshme.

### Perspektiva dhe Rreziqet

**Tërmeti i vitit të kaluar dhe pandemia COVID e këtij viti ka të ngjarë ta çojnë Shqipërinë në recesion dhe të nxjerrin në pah dobësitë e saj të jashtme dhe ato fiskale.** Paketa e qeverisë prej 160 milion eurosh për rindërtimin pas tërmetit, kryesisht për godina banimi, dhe shpenzimet e sektorit privat pritej të mbështesnin një rritje afatshkurtër të PBB-së të nxitur nga kërkesa e brendshme, siç ka ndodhur përgjithësisht pas katastrofave të ngjashme.

**Megjithatë, kriza aktuale shëndetësore ka zbehur ndjeshëm perspektivën e rritjes ekonomike të Shqipërisë.** Efektet e goditjeve të ofertës dhe kërkesës në ekonomi mund të përkeqësohen në disa raste. Ekonomia mund të përballet me goditje të ofertës për shkak të ndërprerjeve në zinxhirin global të furnizimit si dhe një rënie të ofertës së punës për shkak të izolimit në karantinë dhe distancimit social. Duke pasur parasysh paqartësinë e madhe në lidhje me kohëzgjatjen dhe shkallën e përhapjes së pandemisë, efektet negative në kërkesë mund të shtohen me humbjen e të ardhurave nga puna të punëtorëve, veçanërisht në sektorët më të prekur, si turizmi dhe hoteleria, prodhimi dhe tregtia e artikujve jo jetik. Në rastin e mundshëm të një rënie në të ardhurat e disponueshme, familjet do të konsumonin më pak, veçanërisht për mallra të qëndrueshme, dhe kjo do të pengonte materializimin e plotë të efekteve pozitive të rindërtimit. Ndërprerjet e tregtisë dhe sjellja kundërshtuese ndaj rrezikut e investitorëve të huaj ka të ngjarë të shtojnë presionin ndaj vendit. Ekspozimi i Shqipërisë ndaj Italisë, vendi më i prekur në BE, është i konsiderueshëm: Italia është destinacion i 47 përqind të eksporteve (kryesisht produkte të industrisë përpunuese) dhe është burimi i 9.7 përqind të IHD-ve të vendit. Me përhapjen e recesionit në të gjithë BE-në, pritet që goditjet e jashtme të jenë më të larta: BE është destinacioni i 94.9 përqind të eksporteve dhe burimi i 44 përqind të IHD-ve të vendit.

## RRrE për Ballkanin Perëndimor #17

**Për shkak të pasigurisë së lartë të ecurisë së pandemisë COVID-19, për perspektivën e vitit 2020 ne kemi paraqitur dy skenarë.** Skenari bazë supozon se përhapja e pandemisë në Evropë fillon të ngadalësohet me ritme të tilla që masat kufizuese mund të hiqen plotësisht deri në fund të qershorit dhe aktiviteti normal ekonomik të rifillojë në Gjashtëmujorin e dytë 2020. Në skenarin negativ, supozohet se përhapja e pandemisë vijon me ritme tilla që masat kufizuese nuk mund të hiqen deri në fund të gushtit.

**Të ardhurat nga turizmi janë vetëm rreth 15 përqind e PBB-së, por me efektet indirekte të lidhura me ndërtimin, punësimin dhe industri të tjera, turizmi është përgjegjës për rreth 26 përqind të PBB-së.**<sup>2</sup> Turizmi është shumë sezonal dhe siguron pjesën më të madhe të të ardhurave në T3, kështu që vendit do t'i duhej të mbështetej në aftësinë e pronarëve të objekteve për të kryer rindërtimin pas tërmetit, por kjo pritet të vonohet për shkak të izolimit. Nëse masat kufizuese kundër COVID hiqen deri në fund të qershorit, atëherë në kombinim dhe me efektet e tërmetit, parashikimi për turizmin pritet të ulet me një të tretën.

**Industria nxjerrëse e Shqipërisë do të pësojë gjithashtu goditje të fortë** nga një rënie e kërkesës globale, e cila mund të vihet re nga çmimet më të ulëta të mallrave në përgjithësi dhe nga një rënie të vazhdueshme e çmimeve të naftës, duke shkaktuar pasojë të mëdha fiskale dhe ekonomike.

**Sipas parashikimeve të skenarit bazë, Shqipëria do të kalojë në recesion në vitin 2020.** Norma e rritjes ekonomike të vendit pritej të rikthehej në nivelin 3.4 përqind për shkak të rindërtimit dhe rikthimit në nivelet normale të prodhimit të energjisë, por kostot e COVID-19 dhe kufizimet e lidhura me të parashikohet të tkurrin PBB-në me 5 përqind (Tabela 1). Eksportet totale reale parashikohet të bien me 25 përqind, për shkak të rënies së aktivitetit në turizëm, industrinë nxjerrëse dhe përpunuese; importet parashikohet të bien me 9.5 përqind. Tkurrja e aktivitetit ekonomik dhe rritja e pasigurisë do të

zvogëlojnë gjithashtu investimet private dhe konsumin. Qeveria pritet të japë një kontribut të madh në fuqizimin e kërkesës së brendshme nëpërmjet paketave të rindërtimit dhe COVID-19. Në vitin 2021, rritja ekonomike pritet të jetë sërish pozitive duke arritur në rreth 8.8 përqind, për shkak të efekteve të bazës së ulët krahasuesë të eksporteve, konsumit dhe investimeve.

**Rënia e vlerësuar e të ardhurave do të çojë në çekuilibrim të larta fiskale në vitin 2020.** Nivelet më të larta të shpenzimeve për rindërtimin dhe shëndetin, papunësinë dhe përfitimet e mbrojtjes sociale për shkak të krizës do të rrisin raportin e shpenzimeve ndaj PBB-së nga 29.7 përqind në 2019 në 32.4 përqind. Kjo rritje, e kombinuar me një rënie të madhe të të ardhurave tatimore nga 25.7 përqind në 24.2 përqind të PBB-së, do të zgjerojë deficitin fiskal në 5.4 përqind të PBB-së. Nivelet shumë më të ulëta të të ardhurave dhe shtrëngimi i kushteve të financimit mund të imponojnë shkurtime në shpenzime. Raporti i borxhit ndaj PBB-së parashikohet të rritet në 75.8 përqind.

**CAD pritet të zgjerohet në 12 përqind në vitin 2020.** Disbalancat e jashtme janë ende të larta, pasi IHD-të neto parashikohet të bien nga 7.6 në 6.7 përqind të PBB-së në vitin 2020 dhe nevoja për financim nga jashtë për amortizimin e borxhit të huaj të qeverisë është e lartë. Megjithatë, rezervat e mjaftueshme ndërkombëtare të Shqipërisë janë një faktor zbutës.

**Sipas skenarit negativ, Shqipëria duhet të përballet me një recesion më të ashpër ku PBB-ja tkurret me gati 7 përqind.** Një periudhë më e gjatë e ndërprerjes dhe reduktimit të aktiviteteve dhe një tkurrje më e mprehtë e prodhimit dhe eksporteve të industrisë nxjerrëse pritet të rezultojnë në goditje më të forta të kërkesës së brendshme. Sipas këtij skenari, konsumi tkurret në masë më të madhe, me rreth 2.2 përqind në vitin 2020, për shkak të rënies më të madhe të punësimit dhe pagave dhe vijimit të masave të kufizimit të tregtisë me pakicë të artikujve jo jetik. Problemet me likuiditetin do të shtojnë pengesat për investimet private. Në krahasim me skenarin bazë,

<sup>2</sup> Këshilli Botëror i Turizmit dhe Kulturës, 2018.

## RRrE për Ballkanin Perëndimor #17

perspektivat e rritjes afatmesme do të zbeheshin, me rritje të papunësisë dhe përkeqësim të shëndetit financiar të bizneseve.

**Sipas skenarit negativ, disbalancat e brendshme dhe të jashtme do të përkeqësoheshin akoma më shumë.** Rënia e eksporteve neto në vitin 2020 do të rezultonte në një nivel të vlerësuar prej 13.2 përqind të CAD ndaj PBB-së, financimi i të cilit mund të jetë i vështirë për Shqipërinë. Rënia e konsiderueshme e të ardhurave do të përkeqësonte deficitin fiskal, duke arritur në 6.0 përqind të PBB-së, dhe do të rriste borxhin publik dhe të garantuar deri në 77.5 përqind të PBB-së. Duke pasur parasysh pasigurinë në lidhje me ecurinë e pandemisë dhe mundësinë e një valë të dytë të saj, perspektiva është objekt i rreziqeve të konsiderueshme.

**Tabela 1: Shqipëria: Perspektiva 2020**

	Para COVID-19	Skenari Bazë	Skenari negativ
Rritja e PBB-së reale	3.3	-5.0	-6.9
Konsumi	3.1	-1.6	-2.2
Investimet	7.7	1.0	0.8
Eksportet	2.7	-25.0	-30.0
Importet	4.6	-9.5	-10.6

*Shënim.* Vlerësime të satfit të Bankës Botërore. Skenari Para-COVID përfshin efektet e tërmetit dhe rindërtimit.

**Për të mbështetur ekonominë përmes kësaj krize, Shqipëria ka njoftuar ndërmarrjen e një seri masave të politikës ekonomike.** Përveç alokimit të 20 milion dollarë amerikanë më shumë për kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen kundër virusit, masat përfshijnë:

- Një fond të garantimit të kredive për kredi të buta për bizneset që e ndeshen me vështirësi për të paguar pagat dhe kontributet e sigurimeve (100 milion dollarë amerikanë)
- Transferta shtesë sociale për të varfërit, bizneset e vogla dhe përfitimet e papunësisë (65 milion dollarë amerikanë)
- Emergjenca humanitare: US\$20 million për operacionet e emergjencave humanitare
- Amnisti për penalitetet për vonesat në pagesën e faturave të energjisë, nga e cila do të përfitojnë

rreth 211,000 njerëz (150 milion dollarë amerikanë)

- Riskedulim të pagesës së tatimit mbi fitimin për bizneset me qarkullim monetar 17-120 milion dollarë amerikanë.
- Zgjatja e afateve të pagesës së kësteve të kredive për bizneset dhe individët në vështirësi pagese për shkak të COVID-19: ata mund të kontaktojnë institucionet financiare për të riskeduluar pagesën e kësteve të kredive ose të shtyjnë pagesën e interesave të tyre. Nëse arrihet një marrëveshje, bankat nuk kanë nevojë të rritin provigjonet për këto kredi dhe statusi i kredisë së huamarrësit nuk ndikohet.
- Pezullimi i pagesave të qirave për familjet dhe bizneset e vogla të prekura nga kriza.
- Një kontigjencë buxheti që rritet me 10 milion dollarë amerikanë.

**Paketa e masave të politikës ekonomike do të mbrojë disa pjesë të sektorit privat nga humbjet,**<sup>3</sup>

por për të maksimizuar efektivitetin e masave, duhet të adresohen disa sfida të projektimit dhe ekzekutimit të tyre. Autoritetet gjithashtu duhet të mendojnë për një strategji të daljes përfundimtare nga kriza:

- Në një fazë të parë, ristrukturimi i kredisë dhe fondi i garancisë mund të kenë një përdorim të kufizuar, pasi bizneset mund të mos kenë shëndetin financiar dhe stimujt e duhur për të shmangur shkurtimeve të vendeve të punës.
- Masat mund të jenë gjithashtu të nevojshme dhe për bizneset në sektorë që nuk preken drejtpërdrejt, por që vuajnë nga ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit. Madhësia e sektorit informal gjithashtu sugjeron që shumë individë të prekur nuk do të përfitonin nga masat mbrojtëse të sektorit formal.
- Ndërsa reagimi ndaj epidemisë është çështje urgjente, rindërtimi pas tërmetit nuk duhet të anashkalohej. Ndërsa pandemia ka ndalur përkohësisht shumë projekte rindërtimi, është thelbësore të vazhdohet atje ku është e sigurt për ta bërë këtë. Këto projekte gjithashtu mund të

<sup>3</sup> Deri më 7 Prill, qeveria po merrte në konsideratë zgjerimin e paketës me masa për të përmirësuar

likuiditetin e biznesit dhe mbështetjen e familjeve të prekura.

## RRrE për Ballkanin Perëndimor #17

stimulojnë ekonominë e Shqipërisë në vitet 2020 dhe 2021.


**Për të përshpejtuar rimëkëmbjen ekonomike dhe për të ruajtur ritme më të shpejta të rritjes afatmesme, Shqipëria duhet të adresojë si disbalancat fiskale dhe problemin e produktivitetit.**

Megjithëse ekstreme, goditjet e kombinuara të epidemisë dhe tërmetit nënvizojnë rëndësinë e përmirësimit të fleksibilitetit të forcimit të ekuilibrave makroekonomikë dhe rritjes së sektorit privat. Sfidat shtesë lidhen me përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe menaxhimin e zhvendosjeve nga zonat rurale në ato urbane. Reformat strukturore për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe adresimin e fushave të tjera që janë pengesa për rritje të qëndrueshme dhe më të lartë ekonomike do të ndihmojnë gjithashtu në rritjen e fleksibilitetit të ekonomisë.

## RRrE për Ballkanin Perëndimor #17

### Konsumi kontribuoi në rritjen ekonomike në 2019 por investimet ranë.


(Kontributi në rritjen ekonomike, pikë përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka Botërore.

### Borxhi është në rënje për shkak të kontrollit të shpenzimeve.


(Përqind e PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka Botërore.

### Flukset e qëndrueshme jo-borxh-krijuese (IHD) mbuluan plotësisht CAD.


(€ milion)



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore.

### Rritja ekonomike mbështeti rimëkëmbjen e tregut të punës.


(në përqindje)



Burimi: INSTAT.

### Inflacioni qëndroi poshtë nivelit të synuar prej 3 përqind dhe politika monetare ishte përsëri akomoduese.


(në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore.

### Rinisi rritja e kreditimit.

(Kreditimi i ekonomisë, përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore.

## RRrE për Ballkanin Perëndimor #17

### Shqipëria: Tregues të Përzgjedhur Makroekonomikë, 2014 – 22)

SHQIPËRIA	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020 <sup>f</sup>	2021 <sup>f</sup>	2022 <sup>f</sup>
Rritja e PBB-së Reale (në përqindje)	1.8	2.2	3.3	3.8	4.1	2.2	-5.0	8.8	3.6
<i>Përbërja (pikë përqindje):</i>									
Konsumi	5.9	0.0	4.8	3.7	3.9	2.6	-1.3	3.1	2.8
Investimet	-2.5	0.6	-1.7	-0.2	1.0	-1.1	0.2	1.2	0.8
Eksportet neto	-1.6	1.6	0.2	0.3	-0.8	0.7	-4.0	4.5	0.0
Exportet	0.3	0.3	3.3	4.0	1.0	2.0	-8.5	9.8	1.9
Importet (-)	1.9	-1.3	3.1	3.7	1.8	1.3	-4.5	5.3	1.9
Inflacioni i çmimeve të konsumit (në përqindje, mesatare e periudhës)	1.6	1.9	1.3	2.0	2.1	1.4	2.1	2.4	2.8
Të ardhura publike (përqind e PBB-së)	26.3	26.4	27.6	27.7	27.6	27.8	27.0	27.9	27.5
Shpenzimet publike (përqind e PBB-së)	32.3	30.9	29.6	29.8	29.4	29.7	32.4	30.5	29.8
<i>Prej të cilave:</i>									
Shpenzime për paga	5.1	5.1	4.6	4.7	4.5	4.6	4.8	4.8	4.8
Asistencë sociale	11.8	11.3	12.0	12.0	11.6	11.9	13.3	12.7	12.0
Shpenzime kapitale	4.3	4.4	4.0	4.4	4.8	4.5	5.9	5.1	4.8
Bilanci fiskal (përqind e PBB-së)	-6.0	-4.5	-2.0	-2.0	-1.8	-1.9	-5.4	-2.6	-2.3
Bilanci primar fiskal (përqind e PBB-së)	-3.1	-2.2	0.5	0.0	0.4	0.2	-3.0	-0.1	0.0
Borxhi Publik (përqind e PBB-së)	66.1	69.1	68.7	67.8	64.6	63.5	71.2	65.9	63.9
Borxhi publik dhe i garantuar (përqind e PBB-së)	72.0	72.7	72.3	71.9	69.7	68.0	75.8	70.4	68.4
<i>Prej të cilit: I Jashtëm</i>									
Eksportet e mallrave (përqind e PBB-së)	9.3	7.5	6.7	6.9	7.7	6.8	6.3	5.9	5.8
Importi i mallrave (përqind e PBB-së)	31.6	29.9	30.9	31.3	30.2	32.0	30.4	28.7	28.3
Eksportet neto të shërbimeve (përqind e PBB-së)	3.2	5.1	7.4	9.4	8.6	11.4	4.7	8.5	8.6
Bilanci tregtar (përqind e PBB-së)	-19.0	-17.3	-16.8	-15.1	-13.8	-13.8	-19.4	-14.3	-13.8
Fluksi hyrës i remitancave (përqind e PBB-së)	5.9	5.8	5.7	5.5	5.2	5.2	5.0	5.0	5.0
Bilanci i llogarisë korrente (përqind e PBB-së)	-10.8	-8.6	-7.6	-7.5	-6.7	-7.6	-12.0	-7.5	-6.8
Flukset hyrëse të Investimeve të huaja direkte (përqind e PBB-së)	8.1	8.0	8.7	8.6	8.0	7.6	6.7	7.5	7.7
Borxhi i jashtëm (përqind e PBB-së)	69.5	74.4	73.5	68.7	62.9	60.6	n.a.	n.a.	n.a.
Rritja reale e kredimit privat (përqind, mesatare e periudhës)	-1.3	-1.8	-2.1	-2.3	-3.0	2.55	n.a.	n.a.	n.a.
Kreditë me probleme (përqind e totalit të kredive, fundi i periudhës)	22.8	18.2	18.3	13.2	11.1	8.4	n.a.	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë (përqind, mesatare e periudhës)	17.5	17.1	15.2	13.7	12.3	11.5	n.a.	n.a.	n.a.
Norma e papunësisë e të rinjve (përqind, mesatare e periudhës)	32.5	33.2	28.9	25.9	23.1	21.5	n.a.	n.a.	n.a.
Shkalla e pjesmarrjes në forcën e punës (përqind, mesatare e periudhës)	53.7	55.7	57.5	58.3	59.4	60.4	n.a.	n.a.	n.a.

*Burimi:* Autoritetet e Vendit, Vlerësime dhe parashikime të Bankës Botërore.

*Shënime:* Norma e papunësisë për të rinjtë i referohet forcës së punës në grupmoshën 15-29 vjeç.

Mospërputhja statistikore në kontribut është shpërndarë në raportin 80 përqind me 20 përqind midis Konsumit dhe Investimeve përkatësisht.

Ndryshimi në inventare është përfshirë në Investime.